



03.Dhjetor 2008,
Dita Ndërkombëtare e Personave me aftësi të kufizuara

I nderuar, Z.Barak Obama

Urime popullit të ShBA-ve dhe ju personalisht për fitoren historike duke u përzgjedhur presidenti I 44 I Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ishte kënaqësi të dëgjojmë fjalimin tuaj ku u përmenden shumë grupe minoritare, posaçërisht personat me aftësi të kufizuara, kjo tregon që besoni në respektimin diversitetit që është prezent në shoqëri.

Kemi kënaqësinë tu dërgojmë komplimentet tona lidhur me platformën tuaj për personat me aftësi të kufizuara të përbërë nga katër pjesë

- Ngritjen e mundësive për edukim,
- Zhdukjen e diskriminimit, promovimit të mundësive të barabarta
- Rritjen e përqindjes së punësimit të punëtore me aftësi të kufizuara dhe
- Përkrahjen e të jetuarit të pavarur të personave me aftësi të kufizuara

Ne besojmë që kjo do të jetë praktik e cila do ta udhëheq botën në fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara në zhvillimin e plotë të aftësive të tyre duke u bërë anëtare të pavarur të inkuadruar të shoqërisë.

Ne, personat me aftësi të kufizuara të Republikës së Kosovës urojmë Ditën Ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, gjithashtu 60 vjetorin e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut të gjithë miqve dhe kolegëve tanë në ShBA po ashtu edhe ju.

Ky kremtimi e shënon vitin 2008 si vit me rëndësi për lëvizjen globale të personave me aftësi të kufizuara ku Konventës për të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara I është dhënë forcë ligjore dhe është marrëveshja e parë ndërkombëtare e cila do të ofroj mundësit të arrihet vizioni shoqëror ku të gjithë mund të jetojnë me dinjitet dhe respekt

Dhe së fundi ju nxisim, që si lider botëror ta përdorni pozitën tuaj të re për mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara jo vetëm në shtetin tuaj të mrekullueshëm ShBA por edhe në vendet tjera në mbarë botën. Shkurtimisht ne dëshirojmë që ideja juaj e të Drejtave Universale të Njeriut të bëhet realitet për të gjithë ne.

Përshëndetjet tona të për zemrat dhe çdo të mire nga Republika e Kosovës

Hilmnijeta Apuk, Mbrojtës i të Drejtave të Njeriut

Ne emër të anëtareve të Njerëzve të vegjël të Kosovës, partneritetit multi-etnik të OJQ-ve të Programit promovues të Vullnetarizmit - DMD, revistës mujore “Newspaper to the Rights of Persons with Disabilities of Kosovo” në 6 gjuhë , Hendifer – Ferizaj dhe Koalicionit Artistik të kulturës autentike të Personave me Aftësi të kufizuara.

